



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 30/15

Prishtinë, më 16.09.2015, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Ne mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Jelena Bontić, Latif Gashi, Labinot Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Ilir Deda, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Avdullah Hoti – Ministër i Financave, Ekrem Hoxha – kryetar i ARKEP, Fatmir Gervalla-ZKF nga ARKEP, Deniz Jonuzi – udhëheqës i Administratës në ARKEP.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Mentor Hyseni nga GIZ, përfaqësues nga Zyra e Presidentes, gazetar dhe pjesëmarrës nga shoqëria civile.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim: “KSV/018 Mbështetje Institucionale dhe Teknike për sistemin e Furnizimit me Ujë në rajonin e Mitrovicës”**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2015;**
- 6. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2014;**
- 7. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – propozojë se pika e 5 e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e raporti gjashtëmujor të shpenzimeve të Kuvendit, në mungesë të sekretarit të Kuvendit që më ka njoftuar se në mënyrë të pa planifikuar ka shkuar në një vizitë zyrtare në Shqipëri, të shtyhet për një mbledhje tjetër.

Kryetari konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, me ndryshime: pika e 5 e rendit të ditës, shtyhet për shqyrtim në një mbledhje tjetër të Komisionit.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit

Kryetari - konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura të Komisionit, miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim: “KSV/018 Mbështetje Institucionale dhe Teknike për sistemin e Furnizimit me Ujë në rajonin e Mitrovicës”

Kryetari - ky ligj ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes e lidhur ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Luksemburgut, në bazë të së cilës marrëveshje, Qeveria e Luksemburgut jep kontribute në shumë prej 4.5 milion euro. Po janë edhe obligimet e Qeverisë së Kosovës në realizimin e këtij projekti në vlerë prej 1.6 milion euro dhe kjo shumë është e shpërndarë në katër komuna, si: Komuna e Skenderajt merr obligime në shumë prej 200,000 euro, Komuna e Vushtrrisë 300,000 euro, Komuna e Mitrovicës 600,000 euro, ndërsa Zyra Administrative në Mitrovicën Veriore merr një obligim prej 500,000 euro, i cili shumë nuk është planifikuar në buxhetin e Kosovës.

Avdullah Hoti - sqaroj se me këtë marrëveshje po mbështeten projekti i sistemit të ujit në rajonin e Mitrovicës. Ndarjet buxhetore që janë ndarë për komunën e Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skenderajt, po bëjmë përpjekje që të bëhen pjese e buxhetit të rregullt, për pjesën e kontributit që e jep zyra administrative e Mitrovicës së veriut, jemi duke biseduar për përfshirja në buxhetin e vitit të ardhshëm. Jemi duke shikuar mundësitë që mjetet të merren edhe nga fondi për pjesën veriut që është për përmirësimin e jetës së qytetareve për pjesën veriore dhe besojë që e deri në fund të këtij muaji mund të adresojmë edhe këtë çështje. Jemi në proces të përgatitjes së buxhetit dhe brenda ndarjeve buxhetore do të akomodojmë të gjitha këto obligime që dalin nga kjo marrëveshje.

Kryetari – sa i përket obligimeve për Zyrën Administrative të Mitrovicës së Veriut, mjetet që janë grumbulluar nga dy pikat kufitar në pjesën veriore, që kanë të bëjnë me projektet kapitale është një mundësi që obligimet që dalin nga kjo marrëveshje për këtë zyrë, të merren prej atij fondi dhe mos me pas nevojë për mjete shtesë buxhetore për këtë projekt.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim: “KSV/018 Mbështetje Institucionale dhe Teknike për sistemin e Furnizimit me Ujë në rajonin e Mitrovicës”

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së madhe të Luksemburgut

Kryetari – e kemi një marrëveshje tjetër të nënshkruar në mes Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Luksemburgut e që në këtë rast ka të bëjë me mbështetjen e projektit në fushën e shëndetësisë. Në bazë të marrëveshjes, Qeveria e Dukatës së Madhe të Luksemburgut, zotohet që ta jep një kontribut apo

donacion prej 6 milion euro për Kosovën. Qeveria e Kosovës do të ketë detyrime në një shumë prej 3.6 milion euro.

Avdullah Hoti – sqaroi se negociatat për këtë marrëveshje janë zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë. Ministria e Financave ka konstatuar se nuk ka kosto shtesë buxhetore dhe obligimet që merre ministria e shëndetësisë janë brenda buxhetit të kësaj ministrie dhe brenda ndarjeve buxhetore në kornizën afatmesme.

Kryetari – është e nevojshme të jepet një sqarim për obligimet që merr Kosova. Në marrëveshje dhe memorandumit shpjegues flitet për shumën prej 3.6 milion euro që merr qeveria e Kosovës, ndërkaq në vlerësimin financiar që ka bërë Ministria e Financave, iu referohet shumës prej 3 milion euro. A është një lëshim teknik, apo pse ka ndodhur kjo mospërputhje në shifra?

Avdullah Hoti - në pyetjen e kryetarit, sqaroi se është lëshim teknik. Por sikurse edhe te marrëveshja e parë që nuk u përmend, efekte tjera me ratifikimin e këtyre dy marrëveshje për Kosovën janë edhe lirimet nga TVSH-ja për mallrat e shërbimet dhe projekte kapitale te donatoreve dhe në marrëveshjen e parë janë vlerësuar në shumë prej 774,000 euro dhe lehtësira tjera tatimore për mjetet e donatorin me qëllim të realizimit të projekteve.

Kryetari – një çështje tjetër që është vërejtur më shumë si lëshim teknik, ka të bëjë me titullin e projektligjit, ku mungon subjektit i projektligjit dhe propozojë që të bëjmë një amendamente dhe titulli i projektligjit të jetë i ngjashëm me titullin e marrëveshjes.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut, me amendamentin si në vijim:

Amendamenti 1

Titulli i Projektligjit ndryshohet si vijon:

LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES BILATERALE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE QEVERISË SË DUKATËS SË MADHE TË LUKSEMBURGUT PËR PROJEKTIN E BASHKËPUNIMIT PËR ZHVILLIM: “KSV/017: PROGRAMI PËR MBËSHTETJEN E SHËNDETËSISË NË KOSOVË (FAZA II)”

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2014

Kryetari - raporti pasqyron te dhënat për ndarjen e buxhetit sipas ligjit të buxhetit për vitin 2014, që ishte në shume prej 1,209,200€, ndërsa me vendim të Qeverise është bere shkurtim i buxhetit për 15% në kategorinë mallra dhe shërbime. Ndërsa në kategorinë paga dhe mëditje me vendim të Qeverise është rritur buxheti për 25%, pas shkurtimeve buxheti përfundimtar i ARKEP-it ka qene 965,113.22€.

Ekrem Hoxha - e kemi paraqitur raportin financiar për vitin 2014 në Kuvend në procedurat e rregullta dhe niveli i realizimit ka qenë 82% apo në vlera financiare 780,465.03 euro. Sipas kategorive, për paga

dhe mëditje janë shpenzuar 99.39% , mallra dhe shërbime 74% , ne komunal 88%, dhe shpenzime kapitale 68%. Sa i përket mos realizimit të katër projekteve kapitale, ne kemi dhënë shpjegime edhe me shkrim dhe arseja e mosrealizimit është për shkak të mos anëtarësimit të Kosovës në organizmat ndërkombëtare. Autoriteti, në dy vitet e fundit obligohet që ta mbaj një sasi buxhetore të nevojshme për ti përmbushur kriteret për marrjen e kodit të internetit. Sipas ligjeve, Autoritetit është e ngarkuar për themelimin e qëndresë për reagime kompjuterike apo krimi kibernetikë dhe si rregullator i kemi krijuar kapacitete organizative, ligjore e teknike, por nuk i kemi mbushur kriteret për rritje të personelit të mjaftueshëm dhe kjo lidhshmëri e ndikimeve të jashtme që janë jashtë kontrollit tonë, po ndikon në realizimin e projekteve. Ajo që është me rëndësi të theksohet, që katër vite rresht, raportet e auditorit të përgjithshëm kanë konstatuar se nuk ka asnjë theksim të çështjes në menaxhimin e parasë publike. Në kërkesat tona kemi vlerësuar se Autoritetit i duhet pavarësia financiare dhe kjo është kërkesë edhe me direktivat e BE-së.

Kryetari - kemi diskutuar disa herë dhe sot kam pasur këtë temë me organizatën që mbështet komisionin, se duhet ti qasemi të gjitha të gjitha ligjeve, në pjesën që ka të bëjë me financimin e institucioneve dhe agjencive të pavarura, ku kemi laramani të financimit dhe shfrytëzimit të të hyrave vetanake. Sa i përket këtij autoriteti, duhet të bëhet diçka që të financohen përmes të hyrave vetanake, ndërkaq asnjë institucion nuk mund të ketë pavarësi financiare. Këtë institucion e dëshirojmë që të jetë profesional, por dëgjojmë kritika prej drejtorit të Valës, sa i përket pajisjes me licenca për 4G, që do të ishte mirë me sqarue këtë situatë?

Safete Hadergjona - jam shumë e interesuar që të rregullohet çështja e financimit të institucioneve edhe agjencive të pavarura, që është ngritur disa herë, kur dihet edhe numrin e madh të tyre. Ajo që dëshirojë të pyes drejtorin e këtij autoriteti është se çka kupton me pavarësinë financiare? Asnjë institucion nuk mundet me i shfrytëzue të gjitha të hyrat vetanake, por vetëm ato që i nevojiten, sepse po flasim për para publike. Çfarë e ka penguar këtë institucion në realizimin e detyrave të veta me buxhetin që është ndarë nga Kuvendi? Çdo herë keni kërkuar mjete për investime kapitale dhe nuk i keni realizuar projektet kapitale.

Besa Gaxherri – raporti është i përgatitur mirë teknikisht dhe vërejtjet kanë të bëjnë me nivelin e investimeve kapitale. Mendojë që ne duhet të rregullojmë çështjen e financimit të institucioneve të pavarura dhe shfrytëzimit të të hyrave vetanake. Të gjitha të hyrat vetanake duhet derdhen në buxheti e Republikës së Kosovës dhe pastaj ne diskutojmë për buxhetin dhe ndarjen e buxhetit për këto agjencione. Ka agjencione që ka më pak të hyra se sa shpenzon dhe ka agjencione që realizon shumë të hyra, ndërsa realizojnë pak shpenzime. Ne duhet ta marrim qëndrim për të rregulluar çështjen e financimit të institucioneve të pavarura dhe të rregullojmë legjislacionin përkatës në këtë drejtim.

Bardhyl Meta – ky agjencion me pedanteri shumë të madhe e kanë ekzekutuar buxhetin e tyre dhe nuk kemi vërejtje as nga auditori. Kërkojë sqarim sa i përket problemit me 4G, duhet të kemi kujdes pasi që nuk është vetëm Vala e Kosovës por edhe Ipko dhe çdo kompani, qoftë gjermane, franceze apo sllovene, funksionon në Kosovës dhe sipas ligjeve të Kosovës dhe paguan tatim këtu. Pra duhet të kemi kujdes se me një vendim politikë nuk mundeni me thënë që t'ia ndalim Ipkos gjashtë muaj, e ti bënë ca pare vala. Nëse veprojmë kështu, ne nuk kemi me pas kompani të mëdha që investojnë në Kosovë.

Ekrem Hoxha – sa i përket problemit me 4G, të dy operatorët – Vala dhe Ipko, kanë parashtruar ankesa dhe procesi duhet ndjekur sipas ligjit. Ligji për komunikime elektronike, parasheh se dhënien në shfrytëzim jo shitje për një afat të caktuar, kundrejt një çmimi që e cakton rregullatori. Ligji parasheh se rregullatori prej 42 ditëve që është afati me i shkurt e deri në 8 muaj, ta përmbyllet procesi. Nga data 22 korrik kur është përmbyllur procesi i parakualifikimit e këshillimit, tani jemi në fazën e përmbylljes

e shpresojmë ne mes te tetorit ky proces do te përmbillet me vendimmarrje efektive, që gjen aplikim për të dy operatorët në mënyrë proporcionale e te njëtrajtshme e çmimi do te jetë unik për operatorët.

Kryetari – pyeti a ka operator ilegal qe veprojnë ne Kosovë dhe që e dëmtojnë buxhetin Kosovës?

Ekrem Hoxha - kjo është publike dhe informatat i kemi prezantuar të detalizuara në raportet dhe raportimin që kemi bërë në komisionin funksional.

Safete Hadergjona – ne i kemi shikuar Direktivat e BE-së, madje kemi angazhuar edhe ekspertë për të parë përmbajtjen tyre. Por problemi është se vërejtjet që vijnë nga jashtë bazohen në atë çka ju komunikoni me ata dhe vërejtjet janë në dëm të gjithë Kosovës. Kur ju si institucion keni pas mjetet buxhetore të lejuara për shpenzimeve kapitale dhe nuk i keni realizuar projektet, nuk është e arsyetuar të thuhet se nuk kemi pavarësi financiare, kur keni pas mjete të ndara dhe nuk i keni realizuar.

Ekrem Hoxha – mund të jetë mendimi i juaj, por ne kemi bërë raport për katër projektet qe nuk janë realizuar dhe faktor qe nuk janë realizuar nuk jemi ne por mos anëtarësimi i Kosovës në mekanizmat ndërkombëtare.

Kryetar - pavarësi financiare ka të bëjë me shfrytëzimin e mjeteve që këta i bëjnë mos me qenë te varur nga planifikimet e Qeverisë për nevojat e tyre.

Latif Gashi - kryetari e bëri një pyetje se ka operator ilegal që veprojnë ne Kosovë, të kisha lutur të na njoftoni shkurt, pa bërë politike dhe nëse funksionojnë ata operator ilegal, a keni marr ndonjë masë dhe cilat masa apo është mungesë e pavarësisë institucionale qe ju ka penguar në ato masa? Unë besoj që nuk keni pasur pengesa të këtilla dhe keni pas buxhet të mjaftueshëm. Po më intereson me ditë a jeni financuar prej të hyrave vetanake apo nga buxheti i shtetit?

Ekrem Hoxha – theksoi se me Bashkimin Evropiane apo me përfaqësuesit e tyre, ne flasim përmes raporteve zyrtare. Direktivat e BE-së parashohin pavarësinë financiare të rregullatorit dhe kur të fillon Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, kjo është kriter dhe jo çështje e vullnetit të mirë. Rregullatori në vitin 2010 sipas aprovimeve të Kuvendit dhe Qeverisë , i ka sekuestruar dhe konfiskuar shumicën e infrastrukturës komunikuese dhe nuk operojnë në vendin tonë më. Ato po operojnë ne pjesën veriore dhe një stacion me fuqi emituese ne kishën ortodokse në Graçanicë. Me zbatimin e marrëveshjes së Brukselit, shpresojmë të zgjidhet edhe ky problem. Të hyrat qe i marrim nga operatorët derdhen në buxhetin e Kosovës.

Safete Hadergjona – kërkesat buxhetore duhet të përgatiten nga ju. Kuvendi sipas rekomandimeve të Komisionit për Buxhet dhe Financa vendos për buxhetin tuaj. Pavarësinë financiare e keni pasur sepse askush nuk iu ka ndërhyrë në buxhet dhe kërkesat tuaja janë miratuara.

Latif Gashi - më herët thatë se mungesa e financave nuk ju ka penguar operimet e tuaja, ndërsa tani po thoni se është kriter. A do të thotë se na vetë jemi duke e penguar Kosovën drejtë integritetit në organizatat ndërkombëtare, duke u thirrur ne këto qe ju keni mungesë për pavarësi financiare. Nuk e di që keni pas një kërkesë që nuk është aprovuar, qoftë në Qeveri apo Kuvend. Raporti financiar është mirë i përgatitur dhe për çështjet tjera, është përgjegjës komisioni funksional.

Enver Hoti - debati në komision nga ana e pozitës po më bënë përshtypje pasi që po del se këto institucione të pavarura nuk kanë qenë funksionale dhe as brenda ligjit. Me intereson të kemi informata rreth marrëveshjes në mes Z-mobile dh Postës?

Ekrem Hoxha - nuk qëndron ajo që tha deputetja se kërkesat tona po miratohen plotësisht dhe ne mundohemi që në kërkesat tona të paraqesim arsyetime e mjaftueshme dhe është në dispozicionin tuaj a i miratoni apo jo. Sa i përket pyetjes paraprake, marrëveshjet komerciale nuk janë subjekt i rregullimit ekonomik nga rregullatorët dhe për marrëveshjen në fjalë, gjersa operatori apo palët kontraktuese kanë pas autorizimin në tregun elektronik i krijohet baza juridike ligjore për me hy në marrëdhënie komerciale dhe raporti komercial nuk është raport rregullues por janë raporte e tregut të lirë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2014.

6. Të ndryshme

6.1. Kryetari – lidhur me çështjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të propozuar nga nisma qytetare, pyeti ministrin e financave se a është në fazën përfundimtare Projektligji i ri për Menaxhimin e Financave Publike në qeveri dhe a pritet të dorëzohet shpejtë në Kuvend, përndryshe ne duhet të procedojmë me këtë projektligj të propozuar nga nisma qytetare, ku kemi parasysh edhe afatet ligjore për procedim

Avdullah Hoti – njoftoi se Ministria e Financave e ka hartuar draftin-ligjin për financa publike dhe është dorëzuar në Qeveri dhe pastaj të procedohet në Kuvend.

6.2. Kryetari - një çështje tjetër ka të bëjë amendamentin 11 të rishikimit të buxhetit 2014 që është miratuar në Kuvend, që mendojë se nuk është dashur të ndodh, për arsye se është votuar një gjysmë amendament. Janë paraparë ndarja e mjeteve për tri shkolla pa e tregue burimin e mjeteve. Ne kemi marrë një vendim nga qeveria që e adreson këtë çështje dhe kryetari e ka adresuar tek komisioni. Nuk e di se qeveria a ka pas të drejtë të rregullojë këtë çështje, por një është e qartë se çdo ndryshim bëhet vetëm me procedurën e rregullt të amendamentimit. Prandaj, kjo çështje lidhur me amendamentin 11 duhet të konsiderohet si diçka e përealizueshme apo e paplotësuar.

Latif Gashi- unë mendoj se kjo çështje duhet zgjidhur nga qeveria sepse e ka fondin rezervë dhe besoj që nuk ka shumë telashe.

Avdullah Hoti – sqarojë se janë dy amendamente që janë miratuar në Kuvend pa përkrahjen e komisionit funksional dhe janë mjaft problematike. Amendamenti 11 që ka të bëjë me tri shkollat, që nuk tregon burimin, ne kemi marrë një vendim në qeveri dhe mjetet i kemi ndarë nga rezerva dhe është çështje e kryer. Por problemi më i madh është me amendamentin 10 që ka të bëjë me buxhetin e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe për një projekt në vlerë prej më tepër se 1 milion euro që është propozuar të shpërndahen, 80% të atyre mjeteve kanë qenë të shpenzuara dhe jemi në një situatë kur është marrë vendimi për shpërndarjen e mjeteve që pjesa më e madhe janë shpenzuar. Për këtë çështje, në qeveri kemi marrë një vendim dhe kemi dërguar në Kuvend që të rishqyrtohet kjo çështje dhe të anulohet ky amendament, pasi që deputetët kanë marrë një vendim për diçka që nuk ka ekzistencë.

Besa Gaxherri – ajo çfarë na ka ndodhur në rishikimin e buxhetit dhe nëse ne vazhdojmë me këto praktika, që të votohen në Kuvend amendamentet që nuk kanë përkrahjen e Komisionit, atëherë buxheti del prej strukturës së vet dhe kjo nuk do të duhej të ndodhë. Në një situatë kur amendamentet që nuk

kanë kaluar në Komision dhe janë miratuar në Kuvend, ne duhet me shkue me leximin e tretë të buxhetit.

Kryetari – sa i përket amendamentit 10 që ka të bëjë me ndryshimet brenda buxhetit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, që është miratuar në Kuvend, amendamenti teknikisht ka qenë në rregull. Por problemi ka të bëjë me amendamentin 11 apo me tri shkollat, që teknikisht nuk ka qenë në rregull dhe si i tillë nuk mund të zbatohet sepse nuk është precizuar burimi i mjeteve. Qeveria duhet të zbatojë ligjin ashtu siç është miratuar, dhe në buxhetin e vitit 2016, të ndahen mjetet e mjaftueshme për këto tri shkolla në bazë të kostos dhe parallogaritë.

Fikrim Damka - sa i përket amendamentit 10 që është propozuar nga Grupi 6+, ne e kemi bërë sipas shumës që e kemi pa në rishikimin e buxheti, dhe nuk e dimë a janë alokuar apo nisur projektet e sa mjete janë shpenzuar. Këtë çështje e kam ngritur edhe gjatë shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit 2015 dhe mos të krijohet e njëjta situatë edhe në vitin 2016, por le të ndahen mjetet në ministrinë e komuniteteve dhe kthim për të gjitha komunitetet sipas kodeve të veçanta. Kjo duhet të rregullohet në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Kryetari - ne e kemi përmend edhe ne mbledhje të komisionit por edhe në Kuvend, se qeveria duhet me e gjet një formule për ndarjen e mjeteve për komunitetet përkatëse apo Ministria për komunitete dhe kthim duhet me e pas një formulë që është e drejt për te gjitha komunitete.

Latif Gashi - unë mendoj për çështjen e tri shkollave nuk kemi nevojë me thënë se është antiligjore, përderisa është aprovuare në Kuvend është ligjore. Qeveria i ka përdorur praktikën e mëhershme dhe mjetet janë marrë nga fondi rezervë dhe gjithçka është në rregull. Sa i përket çështjes së dytë është mirë ministri me na informue me shkrim nëse ka diçka paqartësi apo që i duhet ndonjë përkrahja e komisionit.

Avdullah Hoti - ne e kemi diskutuar ne qeveri dhe vendimin e marrë e kemi dërguar në Kuvend dhe kemi kërkuar që amendamenti 10 të anulohet, kjo praktik ka qenë me herët për amendamentet teknikisht të pa implementueshme dhe kur do që ju e trajtoni ne jemi te gatshëm.

6.3 Kryetari – propozojë që të formohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për Sigurimet, që është miratuar në lexim të parë në Kuvend.

Sipas propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi formimin e Grupit Punues për shqyrtimin e Projektligjit për Sigurimet, me këtë përbërje: Naser Osmani (kryesues), Latif Gashi (anëtar) dhe Bali Muharremaj (anëtar).

Mbledhja përfundoi në ora 12:15

përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisioni

Naser Osmani